





# 40 HADITHE RRETH JETIMËVE

Tiranë, 2025

Titulli: **40 hadithe rreth jetimëve**

I përzgjedhi dhe i përktheu: Elisabeta **FEZA**

Recensent: Haxhi Shejkh Vullnet **MERJA**

Redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrekttoi: Vjollca **KARAJ**

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie **FEZA**

Kopertina: Sabrie **FEZA**

Botoi: Fondacioni i Kur'anit – Tiranë, 2025

## POZITA E JETIMIT NË KUR'AN DHE NË SUNET

Në ajetin 220 të sures “Bekare” Allahu i  
Madhëruar thotë:

﴿ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْيَتَامَىٰ ۖ قُلْ إِصْلَاحٌ لَهُمْ خَيْرٌ  
وَإِنْ تُخَالِطُوهُمْ فَإِخْوَانُكُمْ ۚ وَاللَّهُ يَعْلَمُ الْمُفْسِدَ مِنَ الْمُصْلِحِ ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ  
لَأَعْتَبْتُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴾

“...Të pyesin ty për jetimët, thuaju: ‘T’u  
bëni mirë atyre është vepër e bukur. Nëse  
jetoni bashkë me ata, dijeni se janë

**vëllezërit tuaj. Allahu di ta dallojë keqbërësin prej mirëbërësit. Sikur të donte Allahu, do t'ju detyronte me punë të vështira. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.'"**

Jetim është çdo fëmijë që i ka vdekur babai, para se ai/ajo të arrijë moshën madhore. Sheriati islam, si në Kur'an, ashtu edhe në Sunet, tregon kujdes të madh për jetimët. Mbi njëzet ajete kanë zbritur, për të sqaruar të drejtat e tyre dhe për të rregulluar çështjet që u përkasin atyre. Gjithashtu, ka shumë hadithe të ardhura nga Profeti Muhamed dhe familja

e tij e pastër dhe e ndritur, që flasin për jetimin.

Një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të umetit dhe shoqërisë ndaj jetimëve është të sillen me drejtësi ndaj tyre. Meqë jetimi është i cenueshëm dhe në rrezik nga padrejtësia, për shkak të dobësisë së tij, Islami e ka përmendur posaçërisht mes njerëzve të tjerë, për të theksuar domosdoshmërinë e drejtësisë dhe shmangien nga çdo lloj padrejtësie ndaj tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“...Silluni me drejtësi ndaj jetimëve. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di mirë atë”.**<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Sure “En Nisa, ajeti 127.

Islami e ndalon ashpër marrjen me padrejtësi të pasurisë së jetimit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Mos iu afroni pasurisë së jetimit, përveçse në mënyrën më të mirë, deri sa të arrijë moshën madhore”**.<sup>2</sup>

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

- *Shmangni shtatë mëkatet shkatërruese!*
- *Cilat janë ato, o i Dërguari i Allahut? – e pyetën.*
- *Shirku (idhujtaria), magjia, vrasja e padrejtë e një njeriu, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, ikja nga*

---

<sup>2</sup> Sure “El En’am, ajeti 152.

*fronti i luftës dhe shpifja ndaj grave të ndershme, të pafajshme, besimtare.*

Në një hadith tjetër, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:

- *Në Ditën e Gjykimit, disa njerëz do të ringjallen nga varret e tyre duke nxjerrë flakë nga goja.*
- *Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?*
- *Ata që kanë ngrënë pasurinë e jetimëve padrejtësisht.*

Në një hadith të saktë, nga Imam Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet:  
*“Mëkatet e mëdha janë shtatë: vrasja me qëllim e një besimtari, shpifja ndaj grave të ndershme,*

*ikja nga beteja, kthimi në jetën e injorancës pas hixhres, ngrënia e padrejtë e pasurisë së jetimit, ngrënia e kamatës, pas njohjes së ndalesës së saj dhe çdo gjë që Allahu e ka bërë shkak për hyrjen në zjarr”.*

Një tjetër përgjegjësi e rëndësishme e shoqërisë ndaj jetimit është përpjekja për ta përmirësuar atë, si në vetvete, ashtu edhe pasurinë e tij. Jetimi është shpesh i ekspozuar ndaj devijimit dhe humbjes, ndaj është domosdoshmëri përmirësimi i gjendjes së tij. Allahu thotë: **“...Dhe të pyesin për jetimët. Thuaj: ‘përmirësimi për ta është më i miri...’”**<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 220.

Ky përmirësim përfshin ruajtjen e pasurisë së tij, mos ekspozimin ndaj humbjes dhe kujdesin për mirëqenien psikologjike të tij, që është edhe më e rëndësishme. Allahu i Madhëruar thotë:  
**“Sa për jetimin – mos e poshtëro!”<sup>4</sup>**

Përgjegjësia më e madhe që i bie shoqërisë dhe umetit, është kujdesi dhe përkujdesja ndaj jetimit, që nënkupton mbrojtjen, edukimin, sigurimin e një jete të dinjitetshme dhe përmbushjen e nevojave të tij. Shoqëria duhet të plotësojë boshllëkun që ka lënë vdekja e babait në jetën e fëmijës dhe ta kompensojë këtë mungesë me dashuri dhe mbështetje.

---

<sup>4</sup> Sure “Duha”, ajeti 9.

Ky kujdes duhet të jetë gjithëpërfshirës, material dhe shpirtëror. Duhet të sigurohet ushqimi, veshmbathja, strehimi dhe trajtimi mjekësor, kur është e nevojshme.

Kur'ani e ka nxitur dhënien për jetimët në shumë ajete, ndër to: **“Të pyesin se çfarë duhet të japin? Thuaj: ‘Çfarëdo të mire që të jepni, le të jetë për prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit dhe udhëtarët. Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di mirë atë’”**.<sup>5</sup>

Dhe: **“Mirësi nuk është që të ktheni fytyrat nga lindja apo perëndimi, por**

---

<sup>5</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 215.

**mirësi është tek ai që beson në Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët, dhe që jep nga pasuria e tij – edhe pse e do atë – për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët, lypësit dhe për lirim të skllëvërve...”<sup>6</sup>**

Hadithet e bekuara, gjithashtu, flasin për shpërblimin e madh për ata që kujdesen për jetimët. Ndër to përmendim:

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në Xhenet kështu” dhe tregoi me gishtin

---

<sup>6</sup> Sure “El Bekare”, ajeti 177.

tregues dhe të mesëm, duke i ndarë pak nga njëri-tjetri.

Dhe: *“Shtëpia më e mirë, në mesin e myslimanëve, është ajo ku ndodhet një jetim që i bëhet mirë, kurse shtëpia më e keqe, është ajo ku ndodhet një jetim që i bëhet keq”.*

Imam Muhamed Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kush ka katër cilësi, Allahu do t'i ndërtojë një shtëpi në Xhenet: kush strehon një jetim, ka mëshirë për të dobëtin, është i dhembshur ndaj prindërve dhe sillet me butësi me shërbëtorin e tij”.*

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të*

*dhe mbi familjen e tij!) të thotë: 'Kush kujdeset për një jetim, deri sa ai të arrijë moshën madhore, Allahu ia bën të detyrueshëm Xhenetin, ashtu siç ia ka bërë të detyrueshëm zjarrin atij që ha padrejtësisht pasurinë e jetimit'''.*

Lloji i dytë i kujdesit ndaj jetimëve është kujdesi kulturor, që nënkupton edukimin dhe pajisjen e tyre me dituri, kulturë dhe njohuri, për t'i shpëtuar nga injoranca dhe analfabetizmi. Po ashtu, jetimi ka nevojë për kujdesje edukative dhe emocionale, sepse me vdekjen e babait ai ka humbur edukatorin dhe përkrahësin e tij.

**Haxhi Shejkh Vullnet MERJA**

## DY FJALË

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur! I Dërguari i Allahut, vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe Ehli Bejti i tij i pastër (*Paqja qoftë mbi ta!*), na kanë lënë një trashëgimi madhështore, thëniet e tyre të bekuara, të cilat përfshijnë të gjithë

jetën e njeriut. Nëse njeriu interesohet për ato thënie, i lexon, i kupton dhe i zbaton në jetën e tij të përditshme. Si rrjedhim, do të arrijë në përfundimin bindës se këto thënie të begata i sigurojnë atij lumturinë në të dyja jetët.

Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti i tij na nxisin që t'i mësojmë përmendësh hadithet e tyre, me qëllim që të bëhen pjesë e kulturës dhe e dukatës sonë dhe, me anë të tyre, të afrohemi tek Allahu i Madhëruar. Kjo gjë ka shumë dobi për besimtarin në Jetën Tjetër.

Në një hadith të ardhur nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Ai që mëson përmendësh dyzet hadithe, Allahu do ta

*ringjallë në Ditën e Kiametit të ditur dhe jurist (fakih)".*

Bazuar në këtë vlerë dhe pasuri të trashëguar nga Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti, Fondacioni i Kur'anit ka grumbulluar, ka përzgjedhur dhe ka përkthyer në gjuhën shqipe **"40 HADITHE RRETH JETIMËVE"**.

Allahu na mbarësoftë të gjithëve në ruajtjen dhe përhapjen e kësaj trashëgimie të vyer e të begatë të Profetit Muhamed dhe të familjes së tij të pastër!

## 40 HADITHE RRETH JETIMËVE

### Hadithi 1

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), ka thënë: “*Shtëpia më e mirë është ajo shtëpi, ku ka përkujdesje dhe dashuri për jetimin*”.<sup>7</sup>

قال رسول الله (صلى الله عليه و آله و سلم): خير بيوتكم بيت فيه يتيم مكرم.

---

<sup>7</sup> “Meuaidhe Adedijeh”, f. 19.

## Hadithi 2

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Kijeni frikë Allahun, se Ai është dëshmitar dhe  
vëzhgues për jetimët! Mos lejoni që herë të jenë  
të ngopur e herë të uritur, mos lejoni që të  
drejtat e tyre të shkelen në shoqërinë tuaj”.<sup>8</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): الله الله في الأيتام! فلا تغربوا أفواههم ولا تضيقوا بحضرتكم.

---

<sup>8</sup> “Nehxhul Belaga”, f. 47.

## Hadithi 3

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Një nga nivelet më të larta të bamirësisë është  
mirësia dhe përkujdesja ndaj jetimëve”.<sup>9</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): من أفضل البرّ الأيتام.

---

<sup>9</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

## Hadithi 4

Hazreti Fatimja (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Allahu e ka bërë haram (të ndaluar) ngrënien e pasurisë së jetimëve, në mënyrë që të drejtat e tyre të mbrohen nga padrejtësia dhe abuzimi”.<sup>10</sup>

قالت فاطمة الزهراء (سلام الله عليها): قَرَضَ اللهُ مُجَابَّةَ كُلِّ أَمْوَالِ الْيَتَامَى اجَارَةً مِنَ الظُّلْمِ.

---

<sup>10</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 79, f. 268.

## Hadithi 5

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kur qan një jetim, Froni (Arshi) i të Gjithëmëshirshmit dridhet nga qarja e tij (jetimit)!”<sup>11</sup>

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): لئن اليتيم إذا بكى اهتز ليكائه عرش الرحمن!

---

<sup>11</sup> “Lialil Ekhbar”, vëll. 3, f. 181.

## Hadithi 6

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Jini të sjellshëm dhe të mëshirshëm me të vejat  
dhe jetimët”.<sup>12</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): ارحموا الأئمة و اليتيم.

---

<sup>12</sup> “Tuhuful Ukul”, f. 147.

## Hadithi 7

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Bëhu për jetimët si një baba i mëshirshëm. Dije se çfarë do të mbjellësh (sot), do ta korrësh (nesër)”.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 77, f. 171.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): كُنْ لِلْيَتِيمِ كَأَبٍ الرَّحِيمِ وَاعْلَمْ أَنَّكَ تَرَوُحُ كَذَلِكَ  
تَحْصُدُ.

## Hadithi 8

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Me të vërtetë, jetimi ka të drejta”.<sup>14</sup>

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): إِنَّ لِلْيَتِيمِ حَقًّا.

---

<sup>14</sup> “Theuabul A’mal”, f. 444.

## Hadithi 9

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Kush e mbron dhe kujdeset për një jetim,  
Allahu do të jetë mbrojtësi dhe kujdestari i  
tij”.<sup>15</sup>

قال الامام جعفر صادق (عليه السلام): مَنْ حَفِظَ يَتِيماً حَفِظَهُ اللهُ.

---

<sup>15</sup> “Lialil Ekhbar”, vëll. 3, f. 181.

## Hadithi 10

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kijeni frikë Allahun për të dobëtit, gratë dhe jetimët”.<sup>16</sup>

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): اتقوا الله في الضعيفين النساء واليتيم.

---

<sup>16</sup> “Khisal”, vëll. 1, f. 10.

## Hadithi 11

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Nëse i ngushëlluari është jetim, përkëdheleni  
kokën e tij me duart e dhembshurisë”.<sup>17</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): ان كان المَعزى يتيماً فامسحْ بِدَيْكِ عَلَى رَاسِهِ.

---

<sup>17</sup> “Kitabul Hadith”, vëll. 3, f. 399.

## Hadithi 12

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
*“Kush kujdeset për të drejtat e jetimit, të tjerët  
do të kujdesen për të drejtat e fëmijëve të tij”*.<sup>18</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): مَنْ رَعَى الْإِيْتَامَ رَعَى فِي بَنِيهِ.

---

<sup>18</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

## Hadithi 13

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
*“Kushdo që fërkon (përkëdhel) kokën e një jetimi, me mëshirë dhe dhembshuri, Allahu do t’i japë dritë në Ditën e Kiametit (për çdo fije floku që e prek dora e tij)”*.<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> “Uesailu Shia”, vëll. 15, f. 111.

قال الامام جعفر صادق (عليه السلام): ما من عبد يمسح يده على رأس يتيم رحمه الله الا  
اعطاه الله بكل شعرة نوراً يوم القيامة.

## Hadithi 14

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kush e siguron një jetim, me paratë e tij, deri sa jetimi të bëhet i aftë për të siguruar jetën e tij, Xheneti i përket atij”.<sup>20</sup>

---

<sup>20</sup> “Uesailu Shia”, vëll. 11, f. 560.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): مَنْ كَفَى يَتِيمًا فِي نَفَقَتِهِ يَلَالَهُ حَتَّى يَسْتَعْفِنِي وَجِبَتْ  
لَهُ الْجَنَّةُ الْبَيْتَةُ.

## Hadithi 15

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Unë dhe kujdestari i jetimit, i cili i frikësohet Allahut të Madhëruar, do të jemi bashkë në Xhenet (si dy gishtat, ai tregues dhe ai i mesëm)”.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> Tefsiri “Nuruth Thekalejn”, vëll. 5, f. 598.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): انا وكافل اليتيم كهاتين في الجنة إذا اتقى الله عزوجل (و أشار بالسبابة والوسطى)

## Hadithi 16

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Sa herë që njëri prej jush ndihet mizor dhe zemërgur, le të përkëdhelë me dhembshuri kokën e një fëmijë jetim, me ndihmën e Zotit, zemra e tij do të bëhet e butë dhe e mirë”.<sup>22</sup>

---

<sup>22</sup> “Uesailu Shia”, vëll. 15, f. 111.

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): مَنْ أَنْكَرَ مِنْكُمْ فِسَاوَةَ قَلْبِهِ فَلَيْدَنْ يَتِيمًا فَلَيْلًا طِفْهُ وَلَيْمَسْخَ رَأْسُهُ يَلِينُ قَلْبُهُ بِإِذْنِ اللَّهِ.

## Hadithi 17

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Jini të sjellshëm me brezin dhe pasardhësit e të  
tjerëve, në mënyrë që të tjerët të jenë të  
sjellshëm me brezin dhe pasardhësit tuaj”.<sup>23</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): أَحْسِنُوا فِي عَقَبِ عَيْرِكُمْ مُحْسِنُوا فِي عَقَبِكُمْ.

---

<sup>23</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 13.

## Hadithi 18

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Në Xhenet ka një banesë (shtëpi) me emrin “Darul Ferah” (Shtëpia e lumturisë – e gëzimit). Askush nuk do të hyjë në të, përveç atyre që gëzuan jetimët e besimtarëve”.<sup>24</sup>

---

<sup>24</sup> “Nehxhul Fesahe”, vëll. 1, f 175.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): إِنَّ فِي الْجَنَّةِ دَارًا يُقَالُ لَهَا «دَارُ الْقَرَحِ» لَا يَدْخُلُهَا إِلَّا مَنْ قَرَحَ يَتَامَى الْمُؤْمِنِينَ.

## Hadithi 19

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Padrejtësia ndaj jetimëve dhe të vejave, shkakton dënim, ndëshkim, privim dhe humbje të begative ndaj atyre që i bëjnë këto veprime”.<sup>25</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): ظَلَمَ الْيَتَامَى وَالْأَيَامَى يَنْزِلُ الْيَقَمَ وَيَسْلُبُ الْيَقَمَ أَهْلَهَا.

---

<sup>25</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

## Hadithi 20

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Edukojeni jetimin në të njëjtën mënyrë si  
fëmijën tuaj”.<sup>26</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): ادِّبِ الْيَتِيمَ مِمَّا تُؤَدِّبُ بِهِ وَلَدَكَ.

---

<sup>26</sup> “Uesailu Shia”, vëll. 15, f. 197.

## Hadithi 21

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kush kujdeset për jetimin e myslimanit dhe e përfshin atë në ushqimin dhe pijen e tij, padyshim që Allahu do ta vendosë atë në mesin e banorëve të Xhenetit, vetëm nëse ai (kujdestari) bën një gjynah që nuk i falet”.<sup>27</sup>

---

<sup>27</sup> “Mustedrek Kadim”, vëll. 1, f. 148.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): مَنْ كَفَلَ يَتِيماً مِنْ الْمُسْلِمِينَ فَأَدْخَلَهُ فِي طَعَامِهِ  
وَسَرَابِهِ أَدْخَلَهُ اللَّهُ الْجَنَّةَ الْبَتَّةَ أَلَّا أَنْ يَعْمَلَ ذَنْباً لَا يُغْفَرُ.

## Hadithi 22

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
*“Bëjuni mirë jetimëve tuaj, ngushëlloni të  
varfrit dhe nevojtarët dhe silluni mirë me të  
dobët dhe të pafuqishmit”*.<sup>28</sup>

---

<sup>28</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

قال امير المؤمنين (عليه السلام): يروا ايتامكم و واسوا فقراءكم و ازرعوا بضعايكم.

## Hadithi 23

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Kushdo që ka këto katër karakteristika: ai që  
strehon jetimin; ai që mëshiron të dobëtin dhe të  
pafuqishmin; ai që mëshiron prindërit e tij dhe

*ai që sillet mirë me varësit e tij, Allahu do t'i ndërtojë një shtëpi në Xhenet".<sup>29</sup>*

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): اَبْتَغِ مَنْ كُنَّ فِيهِ بَنِي اللَّهِ لَهُ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ: مَنْ آوَى الْيَتِيمَ وَرَحِمَ الضَّعِيفَ وَأَشْفَقَ عَلَى الْوَالِدِيَّهِ وَرَفَّقَ بِمَمْلُوكِهِ.

## Hadithi 24

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kini mëshirë për

---

<sup>29</sup> “Theuabul A’mal”, f. 291.

*jetimët e të tjerëve, që të tjerët të mëshirojnë jetimët tuaj”.<sup>30</sup>*

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): تَحَنُّنًا عَلَى آيَاتِ النَّاسِ يُحْمَلُونَ عَلَى آيَاتِهِمْ.

## Hadithi 25

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Kush e ul një jetim

---

<sup>30</sup> “Durexhgehr”, f. 45.

*në tryezën e tij dhe e përkëdhel në kokë, zemra i bëhet e butë dhe mëshiruese”.<sup>31</sup>*

قال رسول الله (صلى الله عليه و آله و سلم): مَنْ أَقْعَدَ الْيَتِيمَ عَلَى خِوَانِهِ وَ يَمْسُحُ رَأْسَهُ بِإِصْبَعٍ قَلْبِهِ.

## Hadithi 26

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: “Allahu i Lartmadhëruar kërkoi drejtësinë e jetimëve,

---

<sup>31</sup> “Sefijneh”, vëll. 2, f. 731.

*sepse ata u shkëputën nga baballarët e tyre, kështu që, kush i ruan ata, Allahu do ta ruajë atë dhe, kush i nderon ata, Allahu do ta nderojë atë”.<sup>32</sup>*

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): حَتَّى اللَّهُ عَزَّوَجَلَّ عَلَى يَرِّ الْيَتَامَى لِإِسْقَاعِهِمْ  
عَنْ آبَائِهِمْ فَمَنْ صَانَهُمْ صَانَهُ اللَّهُ وَمَنْ أَرْكَمَهُمْ أَرْكَمَهُ اللَّهُ.

## Hadithi 27

Imam Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*)  
ka thënë: “Kush e nis ditën dhe nuk ka për  
qëllim t’i bëjë padrejtësi askujt, Allahu do t’ia

---

<sup>32</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 12.

*falë mëkatin e asaj dite, përderisa nuk derdh  
gjak dhe nuk ha paratë e një jetimi në mënyrë të  
paligjshme”.<sup>33</sup>*

قال الامام جعفر صادق (عليه السلام): مَنْ أَصْبَحَ لَا يَتَوَى ظُلْمَ أَحَدٍ عَقَرَ اللَّهُ لَهُ مَا أَذْنَبَ ذَلِكَ  
الْيَوْمَ مَا لَمْ يَسْفِكْ دَمًا أَوْ يَأْكُلْ مَالَ يَتِيمٍ حَرَامًا.

## Hadithi 28

---

<sup>33</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 324.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Bëni kujdes! Kini frikë nga prona e jetimëve.  
Mos e merrni dhe mos u ndotni me të”.<sup>34</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): لا تأْكُلُوا اَمْوَالَ الْيَتَامَى! لا تَعْرِضُوْهَا وَلَا تَلْبَسُوْهَا.

## Hadithi 29

---

<sup>34</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ushqimi më i mjerë është ngrënia (pa të drejtë) e ushqimit të jetimëve!”<sup>35</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): يَنْسُ الْقَوْتُ أَكْلُ مَالِ الْيَتَامِ!

## Hadithi 30

---

<sup>35</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Gjëja më e lehtë, me të cilën një rob hyn në  
Xhehenem është ai që ha një dirhem prej parave  
të një jetimi”.<sup>36</sup>

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): لَنْ أَيْسَرَ مَا يَدْخُلُ بِهِ الْعَبْدُ النَّارَ، مَنْ أَكَلَ مِنْ مَالِ الْيَتِيمِ  
دِرْهَمًا!

## Hadithi 31

---

<sup>36</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 10.

Imam Xhaferr Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kush ha padrejtësisht, qoftë edhe vetëm një dirhem nga pasuria e një jetimi, Allahu, zjarrin e Xhehenemit, ia bën vend të përjetshëm”.<sup>37</sup>

قال الامام موسى بن جعفر (عليه السلام): مَنْ أَكَلَ مِنْ مَالِ الْيَتِيمِ دِرْهَمًا وَاحِدًا ظَلَمًا مِنْ غَيْرِ حَقِّ يُخْلِلُهُ اللَّهُ فِي النَّارِ.

## Hadithi 32

---

<sup>37</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kini frikë Allahun dhe askush prej jush të mos i shpërdorojë paratë (pasuritë) e jetimit, sepse Allahu i Lartësuar do të kërkojë llogari për të, qoftë prej të falurve, qoftë prej të ndëshkuarve”.<sup>38</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): اَتَّقُوا اللَّهَ وَلَا تَعْرِضُوا أَحَدَكُمْ لِلْإِيْتِمِ فَإِنَّ اللَّهَ جَلَّ ثَنَاؤُهُ يَلِي حَسَابَهُ يَنْقِصُهُ مَغْفُورًا لَهُ أَوْ مُعَذِّبًا.

## Hadithi 33

---

<sup>38</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Allahu i Madhëruar premtoi dy dënime për  
ngrënësin e parave të jetimit: ‘Dënim në këtë  
botë dhe dënim në Botën Tjetër’”.<sup>39</sup>

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): لَنْ يَكُونَ اللهُ عَزَّوَجَلَّ وَعَدَ فِي أَكْلِ مَالِ الْيَتِيمِ عُقُوبَتَيْنِ: «عُقُوبَةٌ  
فِي الدُّنْيَا وَ عُقُوبَةٌ فِي الْآخِرَةِ».

## Hadithi 34

---

<sup>39</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 79, f. 269.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Kushdo që i përdor dhe ka në zotim paratë e një  
jetimi ose jep hua diçka prej tyre, ai është  
përgjegjës për të gjitha paratë. Ai është i  
detyruar të paguajë zekatin dhe çdo gjë që i  
përket sipas Sheriatit për to dhe jo jetimi”.<sup>40</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): مَنْ حَوَّلَ مَالَ الْيَتِيمِ أَوْ أَقْرَضَ شَيْئاً مِنْهُ كَانَ ضَامِناً بِجَمِيعِهِ وَ  
كَانَ عَلَيْهِ زَكَاتُهُ دُونَ الْيَتِيمِ.

## Hadithi 35

---

<sup>40</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Rizai (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:  
“Kushdo që bën biznes me paratë e një jetimi,  
çfarëdo fitimi që nxjerr prej tyre, është pronë e  
jetimit dhe çfarëdo që të humbasë prej tyre, do  
të jetë përgjegjësi e tij (përdoruesit të  
parave)”.<sup>41</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): مَنْ أَلْجَزَ بِمَالِ الْيَتِيمِ فَرَحَ كَانَ لِلْيَتِيمِ، وَالْحُسْرَانُ عَلَى التَّاجِرِ.

## Hadithi 36

---

<sup>41</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Padrejtësia dhe dhunimi i jetimëve dhe atyre  
që janë nën kujdesin e tyre, sjell fatkeqësi dhe  
largon mirësitë prej zotëruesve”.<sup>42</sup>

قال امير المؤمنين (عليه السلام): "ظَلَمُ الْيَتَامَى وَالْإِمَاءِ يُنْزِلُ الْيَتَمَ وَيَسْلُبُ الْيَتَمَ أَهْلَهَا."

### Hadithi 37

I Dërguari i Allahut, Profeti Muhamed  
(*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi  
familjen e tij!*), ka thënë: “Katër janë ata që

---

<sup>42</sup> “Fehreste Gurur”, f. 431.

*Allahu i Lartësuar nuk do t'i fusë në Xhenet e as nuk do t'i shijojnë mirësitë e Tij: pirësi i alkoolit, përdoruesi i kamatës, ai që ha padrejtësisht paratë e jetimit dhe ai që është i pabindur ndaj prindërve të tij".<sup>43</sup>*

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله وسلم): أَرَبُ حَقٍّ عَلَى اللَّهِ أَنْ لَا يَدْخُلَهُمُ الْجَنَّةَ، وَلَا يُزَيِّقَهُمْ نَعِيمَهَا: مُدْمِنُ الْخَمْرِ وَآكِلُ الرِّبَا وَآكِلُ مَالِ الْيَتِيمِ بِغَيْرِ حَقٍّ وَالْعَاقِلُ لَوَالِدَيْهِ.

## Hadithi 38

---

<sup>43</sup> "Nehxhul Fesaha", vëll. 1, f. 49.

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:  
“Ngrënia e pasurisë së një jetimi është një nga  
mëkatet e mëdha, për të cilat Allahu ka  
premtuar Zjarrin”.<sup>44</sup>

قال الامام رضا (عليه السلام): لَنْ أَكُلَ مَالِ الْيَتِيمِ مِنَ الْكِبَائِرِ الَّتِي وَعَدَ اللَّهُ عَلَيْهَا النَّارَ.

## Hadithi 39

---

<sup>44</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 5.

Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Ai që ha pasurinë e një jetimi, në Ditën e Kiametit do të ringjallet me zjarr të ndezur në barkun e tij dhe flakët e zjarrit dalin nga goja”.<sup>45</sup>

قال الامام محمد باقر (عليه السلام): لَنْ أَكُلَ مَالِ الْيَتِيمِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالنَّارُ تَلَهَّبُ فِي بَطْنِهِ حَتَّى تَخْرُجَ لَهُبُ النَّارِ مِنْ فِيهِ.

## Hadithi 40

---

<sup>45</sup> “Lialil Ekhbar”, vëll. 3, f. 184.

Imam Xhaferr Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk është (nuk quhet) më jetim, ai që arrin moshën madhore”.<sup>46</sup>

قال لا امام موسى بن جعفر (عليه السلام): لا اثم بعد احوال.

اسم الكتاب: اربعون حديثا عن الايتام

ترجمة الأحاديث: اليسابتا فزا

---

<sup>46</sup> “Biharul Enuar”, vëll. 75, f. 6.

تحت النظر: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: يريدا كولا

التصحيح اللغة: ويولسا كاراي

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: موسسه قرآن - الباني